



## BURSA PËR STUDIME MASTER NË HUNGARI, VITI AKADEMIK 2019-2020

Qeveria e Hungarisë në bashkëpunim me Organizatën e Kombeve të Bashkuara për Bujqësinë dhe Ushqimin (*Food and Agriculture Organization of the United Nations, FAO*) për vitin akademik 2019-2020, ofron bursa studimi për studentë të huaj në programin “Master i Shkencave” në fushat bujqësore e të zhvillimit rural, si dhe ato të agrobiznesit. Programet e studimit (MSc) me bursë në Hungari zgjasin për një periudhë 22 mujore (4 semestra). Bursat ofrohen në fushat dhe universitetet përkatëse sipas listës në vijim:

1. **MSc in Plant Protection**, University of Pannonia, Georgikon Faculty, Keszthely, Hungary;; <http://www.georgikon.hu/english/education/academic-programmes/29-msc-in-plant-protection>; (Application code: “E1”);
2. **MSc in Rural Development and Agribusiness**, the Szent István University, Faculty of Economics and Social Sciences, Gödöllő, Hungary; <http://gtk.sziu.hu>; (Application code: “E2”);
3. **MSc in Agricultural Biotechnology** the Szent István University, Faculty of Agricultural and Environmental Sciences, Gödöllő, Hungary <http://mkk.sziu.hu/application/msc-agricultural-biotechnology>; (Application code: “E3”)

### **Kushtet e aplikimit:**

Të gjithë kandidatët e interesuar për këtë lloj aplikimi duhet të zotërojnë gjuhën angleze dhe të mos e kalojnë moshën 30 vjeç.

Të gjitha dokumentet sipas informacionit bashkëlidhur duhet të jenë të noterizuara dhe të përkthyer në gjuhën angleze. Formulari i aplikimit si dhe dokumentet përkatëse duhet të dërgohen **me postë elektronike** në **formatin PDF ose JPG** deri në datën **28 shkurt 2019, që është edhe afati i fundit për aplikim** në adresën E-MAIL: [REU-Scholarship@fao.org](mailto:REU-Scholarship@fao.org). Për lehtësi procedurale dhe reference çdo dokument duhet të ketë emërtimin më vete.

Qeveria Hungareze, bazuar në marrëveshjen ndërmjet agjencisë FAO (Food and Agriculture Organization of the United Nations) dhe Hungarisë, mbulon të gjitha shpenzimet për procedurat e aplikimit, tarifat e shkollimit gjatë gjithë periudhës së studimeve, shpenzimet e qëndrimit dhe akomodimit (strehim në konvoikt), shpenzimet për materialet bazë (librat). Ndërsa shpenzimet e udhëtimit vajtje ardhje Shqipëri-Hungari-Shqipëri do të mbulohen nga vetë kandidatët.

Theksojmë se për zgjedhja e kandidatëve fitues do të bëhet në bazë të vlerësimit me pikë nga Komisioni i Pranimit pranë universiteteve përkatëse të lartpërmendura, të cilat ofrojnë programin e bursave për shtetasit e huaj. Njoftimi me shkrim dhe publikimi i rezultateve

për pranimin ose jo të aplikimit bëhet përmes këtyre Universiteteve ose Ministrisë së Bujqësisë të Hungarisë pas marrjes së vendimit nga Komisioni i Pranimit të Universitetit.

Lidhur me kushtet për përfitimin e bursës, përshkrimin e detajuar, formularin e aplikimit, si dhe informacione të tjera referojuni materialeve bashkëlidhur këtij njoftimi si dhe faqes web ne adresën:

[http://www.fao.org/europe/news/detail-news/en/c/1073290/;](http://www.fao.org/europe/news/detail-news/en/c/1073290/)

[http://www.fao.org/europe/news/detail-news/en/c/1176118/;](http://www.fao.org/europe/news/detail-news/en/c/1176118/)

**Drejtoria e Integritit, Koordinimit, Marrëveshjeve dhe Asistencës**